

NË KËRKIM TË KOHËS SË HUMBUR

Bashkim **ABAZI**¹

Çdo grimcë e universit është bartëse e një mase vetëdije. Imagjinata kozmologjike e një bote unike nuk e përjashton shpirtin e grimcës fantazëm. Një konstante e pakontrollueshme nga shkenca, me standart intelekt, dikton ekzistencën jetësore.

PËRMBLEDHJE

Në çdo fushë të kërkimit shkencor ekzistojnë qëndrime, që miratojnë apo kundërshtojnë njeri – tjetrin. Edhe për matematikën e ligjeve, të bukurën artistike, moralin e së mirës, zanafillën dhe gjenerimin e femrës, rolin e pashpjeguar të syrit të pandryshueshëm, gjeneza, AND apo ARN, një fushë energjie kozmike apo uji i ngrohtë ...dhe mjaft enigma të tjera - ka fanatikë, dogmatikë, nihilistë, sofistëngazëllues, skeptikë konspirativ dhe dialektikë entuziastë. Në të gjithë mjedisin global po përjetohet ndjesia e fundit e epokës moderne dhe parandjenja e një ndryshimi të madh substancial. Midis të mirës dhe së keqes po endet frika e ndëshkimit nga urrejtja dhe mëkati. Frika dhe pasojat e dështimit të modeleve dhe sistemeve – në funksion të prirjes djallëzore për interesa - kanë nderur dyshime pështjelluese të vetvetes dhe shkatërrimit të mitit enigmatik të ekzistencës. Cilët jemi dhe nga vijmë. Pakënaqësia ndaj filozofisë politike po rritet me sistemin e dështuar të ekonomisë anarkiste dhe shkencës sfiduese. Duket sikur e drejta natyrore e shkakton qëllimisht krizën në çdo gjysëm shekulli. Kjo ndjenjë paradoksale vlen sa vetë nevoja për ribërje, ripërtypje të kapitalit, teknologjisë dhe shërbimeve publike. Nga depresioni i madh 1929, kriza emigratore e 1960, viti 2017 kulmoi në shumësinë e krizave rajonale dhe globale. Në kërkim të identitetit të ri, po e ndryshojmë strukturën e mendimit dhe brenda mentalitetit absurd - po prodhojmë destabilitet dhe anarki. Faza e fundit e rindarjes ka ridimensionuar interesat midis ekonomisë dhe politikës, tregu dhe modelet qeverisëse janë bashkuar dhe kundërshtuar, duke mos e lënë pa deklaruar gabimin me pasoja për popujt dhe kombet.

Fjalë kyçe: kërkimi shkencor, ekzistenca jetësore, ideologjia, gjykimi, koha.

HYRJE

Çdo grimcë e universit është bartëse e një mase vetëdije. Imagjinata kozmologjike e një bote unike nuk e përjashton shpirtin e grimcës fantazëm. Një konstante e pakontrollueshme nga shkenca, me standart intelekt, dikton ekzistencën jetësore. Dilemat: a mund të çlirohet arsyeja nga dogma dhe koncepti i përvojës – empirizmi, të çlirohet nga racionalizmi skeptik përkufizoi konceptin mbi lirinë, kufijtë e saj pengues dhe promovues. I pazotëruar nga çdo qenie njerëzore dhe brenda një psikologjie morale të fizionomisë, mendimi logjik i mundëson karakterit të individit përgjigjen: si shpirti e përçon moralin. Edhe pse nuk e dëshiron, qenia humane është e detyruar të ndjek fatin dhe fatalitetin e saj paradigmatic.

¹Shkrimtar, studiues i filozofisë, profesor nderi.

1. NË KËRKIM TË KOHËS SË HUMBUR

1.1 EKSTRAT EKZISTENCIAL

Në çdo fushë të kërimit shkencor ekzistojnë qëndrime, që miratojnë apo kundërshtojnë njëri – tjetrin. Edhe për matematikën e ligjeve, të bukurën artistike, moralin e së mirës, zanafillën dhe gjenerimin e femrës, rolin e pashpjeguar të syrit të pandryshueshëm, gjeneza, AND apo ARN, një fushë energjie kozmike apo uji i ngrohtë ...dhe mjaft enigma të tjera - ka fanatikë, dogmatikë, nihilistë, sofistëngazëllues, skeptikë konspirativ dhe dialektikë entuziastë. Në të gjithë mjedisin global po përjetohet ndjesia e fundit e epokës moderne dhe parandjenja e një ndryshimi të madh substancial. Midis të mirës dhe së keqes po endet frika e ndëshkimit nga urrejtja dhe mëkati. Frika dhe pasojat e dështimit të modeleve dhe sistemeve – në funksion të prirjes djallëzore për interesa - kanë nderur dyshime pështjelluese të vetvetes dhe shkatërrimit të mitit enigmatik të ekzistencës. Cilët jemi dhe nga vijnë. Pakënaqësia ndaj filozofisëpolitike po rritet me sistemin e dështuar tëekonomisë anarkiste dhe shkencës sfiduese. Duket sikur e drejta natyrore e shkakton qëllimisht krizën në çdo gjysëm shekulli. Kjo ndjenjë paradoksale vlen sa vetë nevoja për ribërje, ripërtpje të kapitalit, teknologjisë dhe shërbimeve publike.

Nga depresioni i madh 1929, kriza emigratore e 1960, viti 2017 kulmoi në shumësinë e krizave rajonale dhe globale. Kapitalizmi demokratik dominues po i përgjigjet sistemit ekonomik dhe institucioneve në modele radikale, pragmatiste dhe liberale. Në kërkim të identitetit të ri, po e ndryshojmë strukturën e mendimit dhe – brenda mentalitetit absurd - po prodhojmë destabilitet dhe anarki. Faza e fundit e rindarjes ka ridimensionuar interesat midis ekonomisë dhe politikës, tregu dhe modelet qeverisëse janë bashkuar dhe kundërshtuar, duke mos e lënë pa deklaruar gabimin me pasoja për popujt dhe kombet. Në dallim nga bota shtazore, qenia humane është një kafshë e pakufizuar, e pakryer. Individit duhet të mësojë atë, që mendon se është i aftë ta zotërojë. Shekulli i XVI-të i përsosi shijet antropike, duke ju shmangur konceptit klasik hedonist se “kënaqësia është arritja e qetësisë së mendimit”. Ky rend budist priset, kur individit synon të formulojë përgjigje përfundimtare të gjërave dhe tenton gjithmonë natyrën apo thelbin e brendshëm të sendeve dhe fenomeneve. Ky perceptim i shkon për shtat rendit klerikal, si një marrëzi e joshjes për të gjetur dhe propaganduar të vërtetën, të përkryerën dhe të përherëshmen – një perceptim, akt dogmatik dhe fanatik. Me vend është cilësimi i Pitagorës se “...politikani është individit, i cili pasi ka mësuar filozofinë, rikthehet në shoqëri për t’u bërë i dobishëm”.

Ai e percepton personalitetin e individit si fizik, energji, sentimental dhe mental. Sekti pitagorian ishte një dëshirë e një besimi të thellë shpirtëror, ai e konsideronte studimin e matematikës si modelin më të mirë të pastrimit të shpirtit. Jo vetëm Pitagora, por edhe Platoni, Aristoteli dhe Hegeli i janë referuar Kultit të Dionisit – shek 7-6 p.e.s si dëshirë për pastërti dhe pavdekësi. Deri më sot, nuk ka asnjë të vërtetë, që nuk është sulmuar, por ka marrëzi të pranuar si e vërtetë. Aspekt delikat përbën ligjëbërja nga standarte formale dhe me intelekt të ulët, individë që nuk e njohin dhe e urrejnë drejtësinë. Krijesa të tilla, të zbrazura nga logjika e trajtojnë ligjin si një forcë imponuese. Filozofia iluministe e shekullit XVIII-të, e përfshirë nga kriza midis racionalitetit – një arsye e ndërtuar tek matematika e Lajbnic-it dhe Volf-it, dhe empirizmit të D.Hjunit u rikthye tek koncepti filozofik i Platonit “... asnjë njohje nuk ka siguri, përveç ndijimit shqisor, pronë e individit është vetëm soditja”. Jo pa shkak, revolta e tij bashkë me Aristotelin e bën atë një të fshehtë të arsyes. Dijetarëve dhe mendimtarëve ju nevojitej euridicioni dhe jo

kërkim i thelluar në një disiplinë. Shkenca nuk mund të zgjidh një problem, pa krijuar disa të tjerë, politika premtion shumë dhe nuk zgjidh asnjë. Një dije e devijuar është më e rrezikshme sesa padituria. Lëvizjet reformatore – politike bazohen mbi oratorinë. Çdo politikan sillet ashtu siç mendon, atij i duket se bota mezi ka pritur të jetojë nën udhëheqjen e tij.

Thelbin e krizës së mendimit e pasqyron E. Kanti me përpjekjen për të krijuar arsyen e kulluar, kundër gjykimit sintetik – formave apriori të gjykimeve sintetike të Aristotelit, dhe teorinë e perceptimeve apo estetikës e përkryer. Dilemat: a mund të çlirohet arsyeja nga dogma dhe koncepti i përvojës – empirizmi, të çlirohet nga racionalizmi skeptik përkufizoi konceptin mbi lirinë, kufijtë e saj pengues dhe promovues. I pazotëruar nga çdo qenie njerëzore dhe brenda një psikologjie morale të fizionomisë, mendimi logjik i mundëson karakterit të individit përgjigjen: si shpirti e përçon moralin. Prelatët dhe demiurgët e politikës mbrojnë barazinë e të gjitha traditave, duke i zëvendësuar vlerat e dikurshme me eklektizmin dhe eliminimin e rrënjëve ideologjike me parrullën e trazirës së paperceptueshme. Përballë joshjes arrogante të jetesës perëndimore, polimorfizmi social i pjesës tjetër kërkon me çdo kusht shartimin e mënyrës së përgjithësuar ekzistenciale të jetesës. Pika e pazhvilluar e qenies humane duhet të jetë konsumi dhe jo konservimi. Për të arritur këtë, çdo gjë duhet të jetë krijim, ngjashmëri dhe përputhshmëri me natyrën dhe stilin e jetës së përditshme.

1.2 KËNAQËSIA EROTIKE E QËNIES

Të prezantosh disfatën e mendimit logjik, në një prirje ndriçuese të njerëzimit për të shmangur rrezikun e rikthimit në barbari, përbën detyrim moral të çdo studiuesi, të përshtatur në mënyrë jetese me mendimin filozofik. Ky orjentim i jep qenies humane karakter të theksuar etiko – praktik për të reflektuar mbi kufizimet e mendimit në qartësimet enigmatike të konvencioneve sociale – jetësore. Rol specifik ka gjuha. Analiza stilistike e gjuhës shqipe ka nxjerrë 11-rrokëshin si rrënjë e shenjtë, e cila e zbukuron logjikën formale, drejt të vërtetave për qenien humane dhe ekzistencën universale. Në pronësi të një individi empirik dhe jo komunikues, ajo kthehet në absurditet, ndëshkuese, me shkallë të lartë dallueshmërie në dije dhe kulturë.

Rol dytësor kanë historianët, që duke e copëzuar të kaluarën historike mbajnë të ngujuar imazhe ideologjike dhe civilizuese. Si individë për ekzistencë dhe përfitime të padrejta, egocentrik dhe gojëshpërfillur – pa i përjashtuar akademikët e qullësuar nga eminencat shumëngjyrëshe - edhe në gjumë e kanë të vështirë të ndahen nga një kohë e largët, e panjohur, plot me mistere dhe kundërshti. E papërtueshme është media e shkruar dhe vizive, që mundëson lojën ngushëlluese të individit me realitetet social-ekonomike. Vrastare dhe e pandalur është politika. E ngjizur në antropologjinë strukturale të pushtetit përvijues ajo përpunon dinamizmin e mentaliteteve humane dhe - në programe elektorale apo doktrina heterogjene - nxjerr në aksionin e saj përfitues dallueshmëri të pakapërcyeshme me kundërshtarin. Një refleksion psikopatologjik dhe fenomenologjik hedh dritë mbi marrëdhënjen e objektit – qenie humane e sëmure dhe subjektit – grupim politik, sipërmarrje, që vuajnë në ekzistencë dhe kuptim progresin social. Le të përpiqemi të demoralizojmë dhe vendosim në kufiza shtrëngese paragjykimin për të hapur personalisht arsyen ndaj gjithë të tjerëve. Për çdo rast, mendimi logjik vjen në model “in extremis” dhe nga një ekstrem tjetër. Parashtrimi i sindromit të personalitetit kriminal e plotëson dilemën qysh në fillësë. Psikoanaliza e hipnozës dhe induktivitetit i përthyen mitet e ngjashëm të psikikës

humane, veçanërisht në të qenurin vrasës të jetës. Manipulues, në ankth dhe panik, me delir madhështie dhe ndikues, profile kriminale arrijnë të përfitojnë dhe gënjejnë lehtësisht. Tërheqës dhe bindës, narcist dhe empatik, kërkojnë me çdo kusht vëmendjen ndaj vetes dhe neveri ndaj nevojave të të tjerëve. Me probleme në fëmijëri dhe difekte të trurit ky profil kriminal përbën rrezik për shoqërinë. Përballë tij qëndron i palëkundur njeriu me logjikë, i prirur tërësisht nga arsyeja, dashuria dhe energjia pozitive.

1.3 ABSOLUTIZIMI I GJYKIMIT

Absolutizimi i gjykimit mposht edhe logjikën më dialektike. Përtej shkencës dhe qenies trashendente, hullitë e tij janë më shumë se sa arsyttime apo mendim logjik. Paradigmat, si nënshtrësia të tij, sendërtojnë apologji me kohën historike dhe vijnë si prurje ngatërrestare të kohës post moderne. Në formë dhe përmbajtje, absolutizmi ruan dhe përjeton ngurtësimin e fushës dhe lëndës. Në rastin më klasik, të një shformëzimi kushtetues për një vend në zhvillim dhe rilindje, ka ruajtur të pacënuar profilin presidencial, kësaj krijese amorfe dhe diabolike të ligjit themeltar me traditën, qytetarinë dhe civilizimin. Në fillesë është absolutja. E pashmangur dhe e vërtetë, ajo i rreket gjysëm të vërtetave. Qenia trashendente është pjesë në përmasën e absolutes, duke e nënkuptuar relativen. Një realitet i papërfytyrueshëm dhe i pakapshëm. Nuk do ta kuptojmë kurrë, është ajo që të ofron me dimensionet logjike të **ndjenjës** – përse je i pashpirt o qenie humane, të **kuptimit** – përse e konsideron veten idiot, kur mund ta quash të zakonshëm midis të barabartëve, **perceptual** – si qenie trashëgimore e një AND-je të mbrojtur nga vlerat dhe jo nga veset dhe **konceptual** – për atë që je, që bën dhe mbyll postmortumin tënd etik. Epikuri, ky atomist dhe themelues i shkencës moderne, ka qenë i prirur drejt vështirësisë së njohjes së të vërtetës, *përderisa perceptimi nëpërmjet shqisave është subjektiv*. Grimca e themelit material – e ngjashme me pikën e ngjizjes biologjike – e vendos të barasvlefshme qenien humane me femrën, këtë specie pjellore të njerëzimit. Shkencat metafizike dhe të natyrës janë të pa afta të na japin një përfytyrim të arsyeshëm të çastit zanafillor të gjenezës familjare dhe prurjeve trashëgimore; ne mburremi deri tek gjyshi apo gjyshja, anatemojmë prindërit dhe stigmatizojmë veten si perëndi.

Përfshirja tek fëmijët – të perceptuar si zero absolute dhe asgjë-ja e tyre, si gjithçka e jona, prindërore – nuk ka ndodhur ende. Ekzistencë e pritshme dhe e turpshme! Jemi ne, absolutistët e gjykimeve, që nuk arrijmë t'u japim kuptim dhe ndjenjë qëndrimeve tona; jemi ne absolutistët e idesë, që nuk tentojmë t'i japim vlerë të skajshme veprimeve tona; jemi ne fatalistët e së ardhmes, që i kemi veshur arsyes sonë murin tërësor të imazhit dhe mistereve. Skajin fundor të maturimit tonë nuk e kemi paramenduar të dobishëm për fillimin e rrugëtimit trashëgimor. Arketipe të politikës, shtetit dhe pushtetit, biznesit dhe shoqërisë civile nuk kanë mundur të japin me sinjeritet dhe pastërti shpirti vështrime përtej murit absurd, të kuptueshëm për atë që kanë bërë, kemi bërë dhe lënë pas. Mjerisht, ata dhe të gjithë ne po trasmetojmë vetëm vështrimet vjedhurazi pas murit rrethues të psikikës sonë të dëmtuar nga veset dhe energjia negative. Një president apo ministër, deputet apo administrator pushteti është i përfshirë nga haluçinacione metafizike, pasojë e një energjie burimore nga hiçi dhe absurdi për jetën. Në etikën time respektohen institucionet, por absolutisht jo individët nën petkun e tyre pervers. Mbi një kohë të matëshme energjie është shpalosur një model përkohësisht jo krijues dhe jo folës. Grimca të reja do të dalin nga asgjë-ja, kjo formë energjie parake do të penalizojë apo do t'i jap madhështi

virtutit të absolutizimit të gjykimit. Përballë misterit absolut, administratori i pushtetit e humb forcën e gjykimit. Në modele tejet relative, ai është me këmbë në tokë, plot demagogji bastarde dhe me dëshirën e fshehur të mbajtjes së kokës në ajër. E kemi të pamundur privilegjin e marrjes së vendimeve, i bindemi me përlulësi dhe shërbesa një autoriteti të jashtëm, por e kemi në dorë psherëtimën e asgjë-së, aksidentin komod të hiçit; çastin fantastik dhe të vetëdijshëm të prurjeve ekzistenciale – semantike për trashëgiminë, historinë, kulturën, artin, religjionin, shembëlltyrën e rilindur të vetvetes. Në absolutizimin e gjykimit nuk ka model standart, përveç rastit relativ apo subjektiv. Në kushte të ndriçimit të shpirtit dhe pagëzimit pas pendimit, rituali legjionar dhe jo religjionar, të ofron lindjen e supozuar të tij. O njeri me pushtet të limituar, unë të kam kuptuar, të kam ndjerë, por ende je në kufiza perceptimi naiv, pa dimensionet e analizës me dritë – jo servile të një lukunie të pangopur modeli pervers – dhe ende larg përlllogaritjeve të kohës me shpejtësi më të madhe apo më të vogël të vetëdijes publike.

Një rrezatim i deritanishëm – nuk kam parë ende fillimin e fillimit – ka dhënë një intensitet politik dhe qeverisës pak gradë mbi vlerën absolute të gjykimit. Materiatrashëgimore është një fosil i një moshe të largët, që në modele përzgjedhëse, të joshjashtë zonës ballkanike, me qëllimin e keq të galëve, hunëve dhe vikingëve. Mbi dhe në interesa kombëtare, të dëshiruara për shqiptarët, i jemi rrekur një mbretërie asimetrike, që e ndryshon drejtimin e duhur në pak të gabuar. Simetria e përsosur është e thjeshtë. Bota kështu ka qenë dhe do të jetë. A mundet në qeverisjen e kohës, me pushtet vullnetlirë, shoqëria të respektojë shtetin – familje, sepse janë të lumtur, sepse ndjehen të barabartë përpara ligjit, sepse duan dhe respektojnë njeri – tjetrin, sepse e dashurojnë jetën, sepse ... A mundemi...!

Sot, bota që njohim dhe prekim është shprehje absolute e një simetrie të ndërprerë gjykimi. Institucionet e vendit janë energji e shpërfytyruar cetrifugale dhe aspak unike, e ngrohtë, mikpritëse, dashamirëse. Jeta që gëzojmë është e pamerituar. Për shqiptarët, ajo është e tillë për shkak të papërsosmërisë dhe mungesës së unifikimit real të energjisë, vlerave, kulturës, pasionit për civilizimin e vërtetë. Dhe për shumë të tjera si këto, që kanë në themel progresin social, dinjitetin kombëtar, vetëdijen krenare, dijen e përkorë dhe trashëgiminë e brezave. Absolutizimi i gjykimit mposht çdo qenie me logjikë. Në ndjesë etike publike, në vëmendje të simetrisë së përsosur institucionale – si harmoni të pushteteve, të shtetit të së drejtës dhe ligjor, të republikës së shpirttrave të etur për lumturi, dhe për shumë të tjera – po i vendos në vëmendje çdo individ me autoritet dhe vendimarrës në këtë kuvend për kujdesin e shëndetit dhe shërbimet publike të shoqërisë, një emër tjetër, me etimologji enigmatike, të misterëshme, pa kufij ndarës dhe të papushtetshëm, jo krijues, jo aktiv dhe jo burimor – një qenie të pangjashme me vetveten dhe qenien humane. Në hulli dyshuese, shpresoj...

1.4 PASOJAT NEUROTOIKE TË IDEOLOGJISË

Edhe pse nuk e dëshiron, qenia humane është e detyruar të ndjek fatin dhe fatalitetin e saj paradigmatic. Ekzistenca dhe sprovë e ideologjisë nuk i përshtaten qenies transhendente, por fillesave të kushtëzuara burimore, që nuk e shmangin antropomorfizmin e saj. Nisur nga dyshimi për hullitë ideologjike të trazuara dhe mbi baza interesi jo vetëm të politikës anglo – saksone referoj me bindje iluminizmin e shek.18-të dhe ecuritë e tij në kohën moderne. Janë prezente në pjesë të mirëpërcaktuara të orbis dhe gëlojnë të njejtat mërmërima të shpirttrave të etur për

pushtet dhe lavdi. Të jetuarit e përditshëm nëpërmjet mendimit përbën jetën e epërme. Jemi thjesht jashtë idesë dhe brenda vetëdijes tunduese të efektit të saj neurotik. Në lojë, jo vetëm londineze, është ekzistenca e miteve, mitologjive dhe doktrinae pragmatiste të qartësuar nga e njëjta strukturë mendimi dhe veprimi, përjashtimisht të pa arritshme për politikën dhe kryesisht të adaptueshme për të zgjedhurit me vullnet lirie të votës. Në lojë është brezi i ri i liderëve elitare, të seleksionuar edhe me vullnet trashëgimie folëse për një gjë, tundues për privilegje dhe memec për gjithçka. Në lojë janë riciklimet e rrënjëzimeve historike pellazgo - ilire, që nuk burojnë nga formëzimet politike, as nga parrullat, simbolet apo tingujt therës të kryqëzatave social – politike, aq më pak nga doktrinat ndjellakeqëse, por nga vetëdije primitive dhe shërbesa riti pagan. Në lojën e fillimshekullit është rindarja, jo ribërja e energjisë dhe territorit. Jam tejet i qartë për vizionin e nisur të projektit londinez 1900, projektit monark v. 1970 dhe pritshmëritë e tij në fundvitin 2025-së. Fabula e Zenonit “qeni shkon nga e tërheq hunda e vet” për ligj kategoritë filozofike të mundësisë dhe realitetit, rastësisë dhe domosdoshmërisë, lajthitjes dhe moralit. Mjerisht, në më shumë se dy dekada, mjedisi ynë ka përtypur me dhimbje psikoza të një ideali dhe idhulli politik të tjetërsuar nga i njëjti mentalitet, ndjesitë e të cilit do të vazhdojnë të trazojnë shpirtrat e lodhur të panshqiptarëve ballkanik.

Përtej logjikës dialektike dhe në model kritik do të na duhet të përtypim të përkorë ligjësitë e pathyeshme të vendimarrjeve jashtë dëshirës dhe vullnetit të kombeve apo perandorive në ringjallje. Jemi në kohën e ç'rregullimit të informacionit global me realitetin rajonal dhe kombëtar, duke demonstruar foshnjërinë e mendimit filozofik për ideologjinë dhe fizikën semantike. Për këtë na nevojitet si ajri dimension i katërt i kohës – e vërteta dhe jo mashtrimi, gënjeshtria, iluzioni, demagogjia, propaganda, përdhosja, poshtërimi... Mjaft ideologji me doktrina dhe parrulla janë regjistruar në memorien e kombeve, duke i fshehur apo mosshpjeguar qëllimet e tyre dhe duke e nënkuptuar deshifrimin e ligjësisë të arsytimit logjik. Çdo entitet politik, brenda dhe jashtë llojit ideologjik, është i përfutur nga bërthama themelore, indet e së cilës ofrojnë boshllëk, mister dhe informacion të dekoduar. E drejta e fjalës publike u përket elitave të mendimit logjik. Përtej vështrimeve shpotitës dhe therës do të na duhet të kapërcejmë me dhimbje çdo model apo sistem të një futurologjie memec. Koha dhe standarti i intelektit dhe teknologjisë e ka reduktuar kritikën e gjatë. Kam parazgjedhur qëndrime pranë universit të së vërtetës, pa e deklaruar atë, për të qetësuar shpirtin tim ngatërrestar. Ideologjia është mbi filozofinë dhe fatkeqësinë e filozofëve të përfshirë në politikë. Ideologjia ka sunduar me modele edhe më barbarë, edhe më të fshehur se sa demokracia, një krijesë në fundin e dritës astrale të Yjesisë së Luciferit. Pubertetet dhe lehonitë e sistemeve dhe mekanizmave funksional të tyre janë rrjedha të gjalluara nga interesa të pandryshuar të dominimeve me lulëzim dhe rënje të perandorive. Jemi në kohën e duhur për pllenimin e gërmave kuineforme me sistemet automatike të teknologjisë së dhënë me receta mjeksore të një eksperimenti dyshues dhe përpunues për qenien humane. Larg energjisë negative dhe brendasferës së qelqit do të na duhet të maturohemi për t'u mos u endur në tretësirën asfiksuese të absurdit të mendimit, pranë eposit filozofik dhe absolutisht të pamenduar tek lajthitja dhe marrëzia e ideologjisë. Ideologjia e pranon mëshirën e predikuesëve dhe diktatorëve, politika në kohën më të keqe tregon dhëmbët, demonstron muskujt. Të pranojmë ekzistencën e merituar historike, le ta jetojmë realitetin e sendërtuar keq midis klithmave barbare të etërve të dyzuar të tradhëtuar në gjenezë dhe t'i drejtohemi autoritetit të arsyes për harmoni dhe drejtësi. Përrullësia e qenies humane vjen jo nga frika ndaj

Krijuesit, por nga nevojat dhe shtrëngesat për mbijetesë, qetësi shpirti dhe dinjtet moral. Fatkeqësisht, kemi thyer diçka poshtë – shpirtin, të rilindur jemi në pragun e rivlerësimit të identitetit kombëtar; këtë po e bëjmë me të njëjtën sindromë ndarëse dhe përfshirëse, të lajkatur nga kënaqësi, që burojnë nga dhimbja. I gjithë ky profil ideologjik i kohës reale është i sendërtuar kundër mendimit të zakonshëm, gjysëm i vërtetë për inteligjencën dhe qartësisht brenda kufizave pseudoshkencore për oligarkinë e pushtetit. Dashuritë e mëdha asnjëherë nuk kanë përfunduar në altarin e kultit. Urrejtjet ideologjike kanë prodhuar me tepëri sundimtarë dhe kundështarë. Le të shpresojmë të ndriçuar në procesionin e vërtetë të qenies ontologjike me antropologji metafizike dhe aura shpirti jashtë rrethit tmerrues të errësirës, padijes dhe deformimeve psikike.

- ***Perversiteti politik i sistemit.***
- ***Historia është gjykatëse, historianët nuk janë gjyqtarë.***

Në prag të luftës së II botërore, L. Vitgenshtain, toger i monarkisë austro-hungareze, hyri tek filozofët e kohës me doktrinën *“hesht për atë, që nuk mund ta thuash”*. Vetëm ajo që parashtrohet qartësisht dhe me logjikë ka kuptim. Filozofi është ndjerë mirë me vetveten, pjesa tjetër ka përtypur perversitetin e efektit të idesë. Koncepti filozofik i shërbeu histerisë së luftës dhe përballimit klasik të tmerreve të saj. Ai pështjelloi në interesa, pasojat e histerisë dhe solli si prurje të përfundimit të *luftës së ftohtë* pretendimet e rendit të ri botëror. Në efekt triptik, kjo e fundit është mjaft interesante. Pas ndarjes së territorit, fitimtarët u kacafytën për dominim, Franca, Anglia, SHBA i diktuan Gjermanisë heshtjen dhe nënshtrimin.

- ***Një pohim është i vërtetë, kur e kundërta e tij nuk mund të provohet.***

Doktrina monarkiste i vendosi në mërmërima psikozat e frikës, për të fshehur dinakërinë dhe poshtërsinë e perandorive - civilizimeve të fuqishme si SHBA, Anglia, Rusia, Franca ... - ndaj shkatërrimeve dhe masakrave të fisnikërisë së zgjuar për pushtet dhe pasuri, skandalet e politikës dhe shërbimeve sekrete si dhe pangopësinë e lobeve fatlumë.

- ***Ç'rregullimi është një stad paraprak i lindjes së një rendi më të lartë, të rregulluar dhe organizuar interesi.***

Jemi në kohën e mëkateve dhe quravitjeve për sundim, për madhështi – *po bindemi se i pari i pushtetit është një lider i lindur* - kundër riformatimit të rendit botëror nga po i njëjti zgjim i kombeve antikë, të lashtë dhe mesjetar. Këtu, dhe vetëm këtu, hullia e frikës dhe e humbjes së vendimarrjes ka përndjekur vetveten, në një dilemë më të ashpër se sa vetë ideologjia iluministe, përgjegjëse për identitetin e tanishëm të çdo shoqërie dhe kombi. Edhe të shoqërisë shqiptare. Një analogji konceptuale me modernizmin e kohës i rrudhos rrjedhat e mendimit me ndjeshmëri dhe nostalgji logjike. Goditjet fatale i merr ***thelbi moral i idesë*** – *jemi jashtë idesë dhe brenda efektit të saj neurotik*, dhe ***mirëqenia sociale*** - si qëllim fundor i filozofisë. Mbas kësaj në dorë mbetet vetëm cinizmi dhe perversiteti politik i qeverisjes.

- Çdo përshkrim optimist i historisë për të ardhmen është iluzion.

Ato që e imponojnë strukturën globale janë kaosi i veprimeve, mospërputhja e qëndrimeve dhe rindarja e privilegjeve kundër popujve dhe kombeve. Hierarki dhe pushtete të trashëguara nga e

kaluara kanë ruajtur domenin e diktatit dhe të sundimtarit për civilizime barbare dhe kanë hequr në disa rojone dhe shtete, të drejtën e debatit, të të qenurit aktor dhe faktor në vendimarrje; ato janë reduktuar vetëm konsensual dhe sfond përgojues i etikës globale. Shumë keq!

- ***Interesat e kombeve të mëdhenj imponojnë dhe i shndërrojnë shoqëritë lutëse dhe qaramane në oaze të përpunimit politik.***

Sistemet e mbyllura – socializmi shkencor, fashizmi, sulltanati, diktatura e proletariatit, totalitarizmi, juntat ushtarake, monarkitë, gjysëm presidenciale - kapërcejnë në mënyra të paevitueshme nga rregulli në shthurjen e ndalshme me vështirësi. Ristrukturimet e tyre janë enigmatike, doktrinare dhe plot dhimbje. Cogito ergo sum i ka dhënë ekzistencës së sistemit dhe perversitetit politik mohimin e dyshimit për mbivendosje të gjenezës dhe të drejtën e gjykimit apriori të qëndrimeve. Koha e ripërthjes servile ka parazgjedhur demagogët e turmave mbllaçitëse dhe dallkaukët klakistë me humorin e Pazarit të Vjetër. Përtej klasicizmit dhe ideologjisë, brenda idesë dhe efektit të saj neurotik dëshmuam modelin më të pamenduar totalitar – ndryshe nga të gjitha vendet e lindjes ideologjike – dhe sistemin më paranojak të demokracisë së dështuar, tinzare dhe poshtëruese. E pamerituara është servitur si e kërkuara dhe e vetmja zgjidhje për jetë të shëndetëshme sociale. Krijesa e saj integruese ka shpalosur pragmatizmin më pervers të qeverisjes dhe politikës. Përtej prirjes së shoqërisë për t'u organizuar, ekziston një shkak për harmoni dhe progres – e drejta për të pasur një qeverisje të mirë, standart inteligjence të perceptueshme në nivelet e realitetit jetësor.

- ***Liria e veprimeve është e kufizuar nga qëllimi i fundit i tyre.***

Ajo nuk i justifikon dështimet e qeverisjes, por lejon shndërrimin e dashurisë dhe pasionit të bindjeve në urrejtje dhe hakmarrje politike. Ky përbën çastin e ekzistencës politike të mjerë. Mbas deshifrimit të hierarkisë së vështirësive dhe shtrëngesave për jetën, pengesave për integritet dhe rilindjen e shoqërisë në drejtimin e duhur, jemi në zanafillë, në pikënisje - fillimi i fillimit. Asnjë ligj dhe parim i filozofisë politike nuk na lejon të analizojmë përzgjedhjen e aleancës evropiane. Doktrina – ende e papërfunduar - na përshkruan vetëm ekzistencën e një tërësie me arketipe të trusteve kriminale, mbetje bastarde të një prurjeje me histori të kapërcyer dhe tendencë të kthimit në origjinë, oaz multikulturor dhe identitete jo kooperuese ekonomiko – financiare, paafërsia për të reaguar në planin global, regjime të ashpra ndaj tregjeve financiare, sisteme dhe evazion fiskalë, që na e mbajnë të fshehur aftësinë për të ndjerë, kuptuar sinjalet inkurajuese dhe pritshmëritë e dëshiruara. Barrierat e shfaqura në këtë komunikim post diktatorial dhe ideologjik lidhen me kulturën dhe religjionin – thelbi sintetik i jetës reale të popujve dhe kombeve. Konceptet mbi krijimin dhe krijuesin, dogmat, qëndrimet sektare, idhujt dhe idhujtarët, profecitë e ditës së fundit, apokalipsit dhe ndëshkimit, një qasje glorifikuese e dhunës deri në ekstremizëm, fundamentalizëm, radikalizëm apo psikozë terrori, formalizimi i dallueshmërisë së besimeve sipas kultit dhe ritit, renditjet në lista paragjyquese për standarte, reforma apo siguri ... vazhdojnë të shkaktojnë tronditje sociale, amulli financiare të tregjeve, kundërshti me pasoja për jetën e njerëzimit dhe shtysa imponuese të kulturës së popujve. Fatkeqësisht, të pakuptuara, të konsideruara lehtësisht ose të servitura djallëzisht tek qeverisja dhe politika, konfliktualitete - me produkt pabarazinë – vazhdojnë të cënojnë harmoninë e planetit dhe entropinë e lëndës ushqyese për jetën. Fatkeqësisht, nderet i mohuar palimpsesti i

përvojës dhe dinamikës midis sistemeve dhe modeleve. Fatkeqësisht, koha e ekzistencës së pritshme po rend pas imazhit pa skrupuj dhe madhështisë formale.

▪ **Qeverisja me pavetëdiqe është një gërmadhë politike.**

Perceptime të tilla na bëjnë të prekshëm ndaj realitetit të shpirtit dhe ritmit dinamik jetësor. Ajo që ka ndodhur është modifikimi i standartit të jetesës, në një marrëdhënie jashtëzakonisht të saktë me realitetin e mëparshme. Parametrat e qeverisjes janë rivendosur në të njejtin nivel demagogjie, po e konsumojnë kohën me të njejtën metodologji politike dhe i kanë dhënë skenës, ekranit, podiumit një gradë më lartë joshjeje perverse. Jemi në kohën e duhur – *me rindarje deri në v. 2025* – për të kuptuar se shoqëria i zotëron virtytet e nevojshëm për të përfutur një qenie të aftë, me vetëdiqe dhe inteligjencë. Një studente nga Kosova zgjidhet prakticante në qendrën më të madhe për hulumtime shkencore dhe laboratorin e fizikës nukleare, inxhinjerisë kompjuterike dhe eksperimentale të grimcave. *Gjeniu shqiptar* ka shembuj të shumtë të vitalitetit dhe energjisë në të gjithë botën. Sot lipset të bëjmë më të mirën dhe më të nevojshmen. Sot duhet guxim për të folur dhe aftësi për të dëgjuar. Ky kuvend përbën guxim për të thënë të vërtetat dhe ata që duhet të dëgjojnë janë apostujt e ekzistencës humane. Ndryshe duhet ta shpallin Shqipërinë park ndërkombëtar zoologjik, me indulgjencë dhe shëlbim të pamëritur shpirti.

2. PËRFUNDIME

1. Pika e pazhvilluar e qenies humane duhet të jetë *konsumi* dhe *jo konservimi*. Për të arritur këtë, *çdo gjë* duhet të jetë krijim, ngjashmëri dhe përputhshmëri me natyrën dhe stilin e jetës së përditshme.
2. E drejta e fjalës publike u përket elitave të mendimit logjik. Përtej vështirimeve shpotitës dhe therës do të na duhet të kapërcejmë me dhimbje çdo model apo sistem të një futurologjie memece.
3. Gjeniu shqiptar ka shembuj të shumtë të vitalitetit dhe energjisë në të gjithë botën. Sot lipset të bëjmë më të mirën dhe më të nevojshmen. Sot duhet guxim për të folur dhe aftësi për të dëgjuar.